

# ANALIZA VJETORE E VEPRIMTARISË SË DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE ME NËNKOMISIONIN PARLAMENTAR, PËR VITIN 2024



13 Shkurt 2025

**Në datën 13 shkurt në mjediset e KLSH-së u zhvillua analiza vjetore për punën e kryer gjatë vitit 2024 të Drejtorisë së Marrëdhënieve me Nënkomisionin Parlamentar.**

Me synimin e institucionalizimit të marrëdhënieve të KLSH-së me Kuvendin e Shqipërisë, në kuadër të rekomandimeve të BE-së, qëllimeve strategjike të KLSH-së, si dhe për të bashkërenduar veprimtarinë e KLSH me Nënkomisionin për auditimin në Sektorin Publik, miratuar nga Kuvendi me Vendimin nr. 70/2024, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit ka ngritur Drejtorinë e Marrëdhënieve me Nënkomisionin Parlamentar, e cila ka si objekt të veprimtarisë së saj, koordinimin e marrëdhënieve me Nënkomisionin për Auditimin në Sektorin Publik (Nënkomisioni), bazuar në fushëveprimin dhe kompetencat e tij.

Gjatë fjalës së saj znj. Brunilda Zeneli, drejtore e kësaj drejtorie u fokusua në punën e bërë nga kjo drejtori brenda këtyre gjashtë muajve që nga data e krijimit të saj dhe sfidat që e presin në të ardhmen, duke e parë KLSH-në dhe Kuvendin si pjesë të trekëndëshit të llogaridhënies, me role reciprokisht mbështetëse për të siguruar një qeverisje efektive dhe mirë menaxhim të parasë publike.

Gjithashtu, u theksua fakti se viti 2024 ka qenë intensiv në bashkëpunimin KLSH-Kuvend, ku KLSH ka marrë pjesë në 5 seanca dëgjimore mbi Raportin e Performancës së KLSH-së dhe në seancën dëgjimore mbi Raportin mbi Zbatimin e Buxhetit të Shtetit (për vitin 2023) në Komisionin për Ekonominë dhe Financat; ka marrë pjesë në të gjitha seancat dëgjimore në Nënkomision për Auditimin në Sektorin Publik mbi shqyrtimin e raporteve të auditimit; ka marrë pjesë në dy komisione parlamentare, si dhe në disa aktivitete të përbashkëta të zhvilluara midis anëtarëve të Nënkomisionit për Auditimin e Sektorit Publik dhe stafit të Drejtorisë së Marrëdhënieve me Nënkomisionin Parlamentar në KLSH të organizuara nga NDI, në lidhje me domosdoshmërinë e intensifikimit të bashkëpunimit KLSH - Kuvend, si dhe rritjen e nivelit të këtij bashkëpunimi duke siguruar llogaridhënie, transparencë dhe pavarësi institucionale.